

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti Ekonomik</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>E drejta financiare</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Zgjedhore</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>Viti I- Semestri II</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2 + 1</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>4</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Caktohet me vonë</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof.Dr. Armand Krasniqi, Msc. Diamanta Sojeva</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b><u>armand.krasniqi@uni-pr.edu</u> <u>diamanta.sojeva@uni-pr.edu</u></b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Lënda “E Drejta Financiare” trajton rregullimin juridik të veprimtarive financiare të shtetit dhe institucioneve të tjera të së drejtës publike. Ajo fokusohet në funksionet, strukturën dhe mekanizmat përmes të cilëve realizohet grumbullimi, shpërndarja dhe përdorimi i mjeteve financiare publike. Përmbajtja e lëndës ka karakter të thellë ekonomik dhe juridik njëkohësisht, pasi ndërthur konceptet e financave publike me analizën e normave ligjore që i rregullojnë ato. Studentët njihen me sistemin tatimor, buxhetor dhe institucionet e menaxhimit të financave publike, duke përfshirë legjislacionin relevant dhe praktikën bashkëkohore të financimit shtetëror.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi i lëndës “E Drejta Financiare” është të pajisë studentët me njohuri të thelluara mbi rregullimin juridik të financave publike dhe funksionimin e institucioneve financiare shtetërore. Ajo synon të zhvillojë të kuptuarit kritik dhe analitik të studentëve për çështje të tilla si: grumbullimi i të hyrave publike, planifikimi dhe shpërndarja e mjeteve financiare, struktura dhe funksionet e sistemit buxhetor, si dhe kontrolli institucional mbi financat publike. Lënda gjithashtu synon të ndërtojë kompetenca praktike për interpretimin e ligjeve financiare dhe për vlerësimin e politikave fiskale, duke i përgatitur studentët për sfida konkrete në menaxhimin publik financiar.

<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Në përfundim të lëndës, studenti pritët të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptojë kategoritë themelore të financave publike nga perspektiva juridike dhe ekonomike;</li> <li>• Shpjegojë dhe analizojë marrëdhëniet juridiko-financiare dhe funksionimin e institucioneve që menaxhojnë financat publike;</li> <li>• Bëjë krahasime midis sistemeve dhe praktikave të ndryshme të financimit publik, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar;</li> <li>• Vlerësojë mënyrat e mbledhjes dhe shpërndarjes së mjeteve financiare për qëllime publike dhe të formulojë qasje kritike mbi efektivitetin e politikave buxhetore;</li> <li>• Zbatojë njohuritë ligjore në interpretimin e dispozitave përkatëse të legjislacionit financiar, përfshirë ligjet për buxhetin, tatimet dhe kontrollin financiar shtetëror.</li> </ul>
---	---

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	13	26
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume,seminare	3	3	6
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja përfundimtare për provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	5	10
Projektet, prezantimet ,etj	-	-	-
<b>Totali</b>			<b>100</b>

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Mësimdhënia bazohet në një qasje të kombinuar
-------------------------------------	---

	<p>ndërmjet ligjëratave teorike dhe ushtrimeve praktike. Ligjëratat zhvillohen përmes prezantimeve interaktive, me përdorimin e mjeteve moderne vizuale dhe përfshirjen e studentëve në diskutime lidhur me temat e trajtuara. Ushtrimet synojnë zbatimin e njohurive përmes analizës së rasteve studimore, punimeve seminarike dhe debateve të organizuara në grupe. Studentëve u ofrohet mundësia që, përmes punës kërkimore dhe prezantimeve, të përvetësojnë jo vetëm bazat teorike të së drejtës financiare, por edhe të zhvillojnë shkathtësitë praktike dhe analitike për zgjidhjen e çështjeve konkrete të financave publike. Kjo qasje synon nxitjen e mendimit kritik, vetëvlerësimin dhe përfshirjes aktive në procesin mësimor.</p>
<b>Metoda e vlerësimit:</b>	
<p><b>Vlerësimi në %</b>  91 – 100% = nota 10  81 – 90 % = nota 9  71 – 80% = nota 8  61 – 71% = nota 7  51 – 60% = nota 6  0 – 50% = nota 5</p>	<p>Vijimi i ligjëratave = 0%  Ese / prezantim = 10%  Punimi seminarit = 0 %  Testi i parë = 25%  Testi i dytë = 25%  Testi i tretë = 35%  Pjesëmarrja në ushtrime = 0%  Aktiviteti në ushtrime = 5%  Puna grupore dhe rasti i studimit = 0%</p>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Dr. Bedri Peci: SHKENCA MBI FINANCAT DHE E DREJTAT FINANCIARE, Prishtinë 2017</li> <li>2. Dr. Drita Konxheli –Radoniqi: Financat Publike, Prishtinë 2019</li> <li>3. Dr. Sabri Kadriu: Financat publike , Prishtinë 2012</li> <li>4. Genta Tafa (Bunga):Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare, Tiranë 2009</li> <li>5. Dr. Sabahudin Komoni: Financat Publike, Prishtinë 2008</li> <li>6. Gani Asllani &amp; Vehbi Imeri. E derjta fiskale dhe ndertimi i sistmit tatimor. 2016. Prishtinë;</li> </ol>
<b>Literatura shtesë e preferuar:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Materiale nga librat tjera dhe nga interneti që i kushtohet financave dhe drejtës financiare apo</li> </ol>

	financave publike ne çdo gjuhe; 2. Ligji mbi menaxhimin e financave publike ( i Kosovës dhe i Shqiperisë); 3. Kodin doganor dhe të akcizave në Kosovë; 4. Ligji i buxhetit të Kosovës; 5. Ligji Nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së auditorit të përgjithshëm dhe Zyrës së auditimit të Kosovës; 6. Ligji i tatimit të ardhurave personale, etj 7. Legjislacioni për tatimet; 8. Menaxhimi i shpenzimeve publike, Tiranë, 2004;
--	---

#### **Plani i dizajnuar i mësimit:**

<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Prezantimi i programit Hyrje në shkencën mbi financat dhe drejtën financiare
<i>Java e dytë:</i>	Kuptimi i përgjithshëm i të hyrave publike dhe klasifikimi i tyre
<i>Java e tretë:</i>	Rëndësia e parimeve të të hyrave tatimore - financiare (Këndëvështrim ekonomik)
<i>Java e katërt:</i>	Përkufizimi dhe rëndësia e tatimeve – teoria dhe praktika financiare
<i>Java e pestë:</i>	Kuptimi dhe llojet e shpenzimeve publike
<i>Java e gjashtë:</i>	<b>Testi i parë:</b> Kuptimi, zhvillimi dhe definicioni i tatimit
<i>Java e shtatë</i>	Klasifikimi i tatimeve
<i>Java e tetë:</i>	Efektet e tatimit; Parimet e tatimeve ne bashkimin evropian
<i>Java e nëntë:</i>	Tatimet e dyfishta
<i>Java e dhjetë:</i>	Taksat dhe kontributet
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<b>Testi i dytë;</b> Huaja shtetërore – publike, kuptimi ndarja dhe parimet e huase publike
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Doganat -Kuptimi i doganave, ndarja, sistemi dhe politika doganore; Akciza
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Buxheti dhe e drejta buxhetore
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Kontrolli i buxhetit në teorinë dhe praktiken buxhetore
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<b>Testi i tretë:</b>

#### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore. Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.